



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 324/14 Prot.

Pogradec, më 28.01.2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim dhe miratim

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

E nderuar znj Kryetare,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim Projekt Vendimin për:

**“ PËR MIRATIMIN PAGËS MINIMALE NË BASHKISË POGRADEC DHE  
NDËRMARRJEVE NË VARËSI ”**


Me respekt,

**KRYETAR  
Ilir XHAKOLLI**

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1 ( një)

Nr. i faqeve A4 të relacionit shoqërues: 1 ( një)

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 0 ( zero)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. \_\_\_\_ .Prot

Datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026

PROJEKT- VENDIM

NR. \_\_\_\_ , DATË \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026

PËR

“ PËR MIRATIMIN PAGËS MINIMALE NË BASHKINË POGRADEC DHE  
NDËRMARRJEVE NË VARËSI ”

Në mbështetje të nenit 54, shkronja “ç”, nenit 55, pika 2, të Ligjit nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore ”, i ndryshuar, ligjit nr. 152/2013 “ Për nëpunësin civil ”, i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “ Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 44/ 2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, neni 2, shkronja “c”, Ligjit nr. 10 405, datë 24.03.2011 “ Për kompetencat përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve ” Vendimin e Këshillit të Bashkisë, Nr.128, datë 22.12.2025 “Për miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Poogradec per vitin 2026’, Vkm-së nr. 776, datë 19.12.2025 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi ”,

KËSHILLI BASHKIAK  
VENDOSI:

1. Paga minimale bruto mujore e punonjësve të Bashkisë Pogradec, Njësive Administrative, Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike, Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekreacionit dhe Qendrës Arsimore dhe Angjenica e Mbrojtjes së Territorit, të jetë **50 000 (Pesëdhjetë mijë) lekë.**
2. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më datë **01.01.2026.**
3. Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr. 28, datë 21.03.2023 **shfuqizohet.**
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar pranë Bashkisë Pogradec, si dhe Ndërmarrjet në varësi të saj.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

**KRYETAR**  
**Manjola KAMOLLI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
SEKTORI I MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE ÇËSHTJEVE ADMINISTRATIVE

Pogradec, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026

**RELACION**

**“ PËR MIRATIMIN E PAGËS MINIMALE NË BASHKINË POGRADEC DHE  
NDËRMARRJEVE NË VARËSI ”**

I nderuar Kryetare e Këshillit,

Të nderuar Këshilltarë,

Me Vendimin nr. 776, datë 19.12.2025 Këshilli i Ministrave ka miratuar pagën bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi, të detyrueshme për zbatim nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, në nivelin **50 000 (pesedhjete mijë) lekë**.

Projekt-vendimi që po ju paraqesim bazohet në Vendimin e mësipërm të Këshillit të Ministrave dhe është i domosdoshëm për të përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në gërmën ‘’ç’’ të nenit 54 të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Si rrjedhojë e rritjes së pagës minimale, e cila kalon nga niveli **40 000 (Dyzet mijë) lekë** lekë në nivelin **50 000 (pesedhjete mijë) lekë**, propozojmë ndryshimin në nivelin e pagës për punonjësit e shërbimeve sipas kategorizimit të pozicionit të punës.

Kjo rritje do përballohet nga buxheti i Bashkisë Pogradec, të miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 128, datë 22.12.2025 “Për miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026 ”,

Nga ndryshimi i pagës minimale përfitojnë 320 punonjës të Bashkisë Qëndër dhe Ndërmarrjeve në Varësi,

Në zbatim të VKM- së 776, 19.12.2025, efektet financiare fillojnë nga data **01.01.2026**

Hartoi: Specialist Sektori Pamela Gora 

Miratoi: Drejtor Laura Elmasllari 

Konfirmoi: Drejtor Kabineti Alma Kanina 

**KRYETAR**  
**Ilir XHAKOLLI**

